

## UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1Z

### I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. **Formulari A1Z** plotësohet, për t'u regjistruar në Maturën Shtetërore 2012, nga të gjithë ata që nuk janë maturantë të vitit shkollor 2011 – 2012. Këtë formular e plotësojnë edhe shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë shtetit.
2. **Formulari A1Z** plotësohet me stilolaps (me një ngjyrë, blu ose të zezë) dhe me shkronja të mëdha të shtypit.
3. **Formulari A1Z** konsiderohet i vlefshëm **vetëm** nëse ai është plotësuar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme. Në rast të kundërt ai do të konsiderohet i pavlefshëm dhe kandidati humbet të drejtën e regjistrimit.
4. **Formulari A1Z** dorëzohet në **Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore (KShMSh)**, ku kandidati ka mbaruar shkollën. Në çdo rast tjetër, ky formular dorëzohet në KShMSh-në e përcaktuar nga DAR/ZA-ja
5. Shpërndarja, plotësimi dhe dorëzimi i **Formularit A1Z**, fillon më **20 shkurt 2012** dhe përfundon më **10 mars 2012**.
6. Në rast se maturanti/kandidati ka bërë gabime në plotësimin e formularit, ai mund të plotësojë një tjetër Formular **A1Z**, brenda afatit të dorëzimit, duke bërë të pavlefshëm e duke asgjësuar formularin e plotësuar gabim.
7. **Formulari A1Z**, pas plotësimit, kontrollohet me kujdes për saktësinë dhe më pas firmoset nga maturanti/kandidati, anëtarin e KShMSh-së dhe drejtorin e shkollës.
8. **Çdo formular vulloset me vulën e shkollës**

### II. UDHËZIME TË VEÇANTA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT

Në hapësirat e lëna bosh në pikat 1 – 11, tek Formulari **A1Z**, të plotësohet:

1. emri i DAR ose ZA, ku ndodhet shkolla, pranë së cilës maturanti/kandidati do të me Formularin A1Z;
2. emri i qytetit ose fshatit, në të cilin ndodhet shkolla;
3. emri i shkollës ku maturanti/kandidati është caktuar të aplikojë me Formularin A1Z;
4. bazuar në tabelën e Indekseve e profileve/degëve, shënoni numrin që përfaqëson dega që ju keni ndjekur; p.sh: Gjimnazi-**drejtimi shoqëror**, në tabelë ka indeksin 02, në formular ju do shënoni numrin 02. (Plotësohet në bashkëpunim me anëtarin e KShMSh)
5. □ EMRI □ ATËSIA □ MBIEMRI

#### **Kujdes!**

- Të dhënat të shënohen në përputhje me dokumentin e identifikimit.
  - Emrat që përmbajnë shkronjat (**Ë**) dhe (**Ç**) të shkruhen saktësisht si në dokumentin e identifikimit.
6. ID që maturanti/kandidati ka patur në Maturën Shtetërore para vitit 2012. Nëse jeni pajisur dy a më shumë herë me ID, të shënohet në kutinë e parë **vetëm** ID e vitit të fundit. (Plotësohet nga drejtori i shkollës). Në qoftë se nuk keni patur ID, kutia para “JO”-së, plotësohet me **X**.
  7. datëlindja e maturantit/kandidatit, duke plotësuar përkatësisht me dy shifra ditën dhe muajin dhe me katër shifra vitin, sipas formatit dd/mm/vvvv;
  8. vendlindja e maturantit/kandidatit;

9. me shenjën **X** në kutinë që i përket gjinisë së maturantit/kandidatit. P.sh: nëse i përket gjinisë femërore shënon **X** në kutinë përbri fjalës “Femër”;
10. numri i telefonit të kontaktit të maturantit/kandidatit dhe adresa e email-it
11. me shenjën **X** në kutinë PO, nëse do të vazhdoni studimet jashtë shtetit, ose në kutinë JO, nëse nuk do të vazhdoni studimet jashtë shtetit;
12. viti i përfundimit të shkollës së mesme (vetëm për kandidatët);
13. lëndët e detyruara që maturanti/kandidati ka dhënë. Në rast se nuk keni dhënë asnjë ose vetëm një provim, shënoni **X** në të dy hapësirat ose vetëm në atë që nuk keni dhënë.
14. Maturanti/kandidati nuk lejohet të rijapë provimet me zgjedhje të detyruar, nëse ka rezultuar kalues në maturat e viteve të mëparshme, me përjashtim të rastit kur rezultatet e tij janë nën 4.50. Në rast se maturanti/kandidati e ka dhënë më shumë se njëherë një lëndë/lëndët në provimet me zgjedhje, i njihet vetëm rezultati i fundit. Në përlllogaritjen e pikëve për sistemin meritë-preferencë për këto lëndë merren koeficientët e vitit shkollor 2011-2012.
- 14.1. Në hapësirën bosh, të shënohet emri i lëndës/lëndëve me zgjedhje që do mbartet/n dhe vitin kur është/janë dhënë provim kjo/këto lëndë.
- Shënoni përkatësisht lëndën/lëndët me zgjedhje të detyruara që keni dhënë. Në rast se nuk keni dhënë asnjë/një provim, shënoni “X“, në të dyja /njërën hapësirat/hapësirë.
- 14.2. Nëse keni mbartur **dy lëndë me zgjedhje** nga Matura Shtetërore e viteve të mëparshme, **kërkesa 14.2 e këtij Formulari, nuk plotësohet.**
- a.** Nëse keni mbartur vetëm një lëndë me zgjedhje nga Matura Shtetërore e para vitit 2012 dhe në tjetrën keni marrë më pak se sa 4.50, atëhere, në listën e lëndëve me zgjedhje, duhet të qarkoni një lëndë, në përputhje me kriterin e plotësimit të 8 krediteve të parashikuara në Udhëzimin Nr 40, datë 12.10.2011. Nëse lënda që keni mbartur është gjuhë e huaj, lënda që do të qarkoni, në listën e lëndëve me zgjedhje, **mund të jetë edhe gjuhë e huaj e dytë, por e ndryshme nga ajo që do të mbartni.**
- b.** Nëse **nuk** keni dhënë lëndë me zgjedhje në Maturat Shtetërore para vitit 2012 atëhere duhet të qarkoni **më poshtë, lëndët me zgjedhje** sipas Udhëzimit Nr 40, datë 12.10.2011 .

P.sh:

**8. BIOLOGJI**

**34. ANGLISHT (Gj e huaj e dytë)**

**Shënim.**

- Lëndët me zgjedhje të përcaktohen sipas Udhëzimit Nr 40, datë 12.10.2011 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2012”.
- Maturanti/kandidati firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Anëtari i KShMSh shkruan emrin dhe mbiemrin dhe firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Drejtori shkruan emrin dhe mbiemrin, firmos dhe vulos me vulën e shkollës në hapësirën e përcaktuar për të.

Tabela e indekseve/profileve të Maturës Shtetërore 2012

INDEKSI I PROFILIT	LLOJI SHKOLLES
01	GJIMNAZI DREJTIMI NATYROR
02	GJIMNAZI DREJTIMI SHOQËROR
03	GJIMNAZI DREJTIMI I PËRGJITHSHËM
04	GJIMNAZI 2012
05	GJIMNAZI ME KOHË TË SHKURTUAR
06	NATYROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
07	SHOQËROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
08	SHOQËROR 2 GJUHËSH ITALIANE
09	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-FRENGJISHT
10	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-ITALISHT
11	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT
12	GJUHË E HUAJ ANGLISHT
13	GJUHË E HUAJ FRËNGJISHT
14	GJUHË E HUAJ ITALISHT
15	GJUHË E HUAJ GJERMANISHT
16	GJUHË E HUAJ SPANJISHT
17	GJUHË E HUAJ RUSISHT
18	GJUHË E HUAJ SPANJISHT-RUSISHT
19	ARTISTIKE KOREOGRAFI
20	ARTISTIKE ARTE FIGURATIVE
21	ARTISTIKE MUZIKË
22	SHKOLLA SPORTIVE 4-VJEÇARE-FUTBOLL
23	SHKOLLA SPORTIVE 4-VJEÇARE-ATLETIKË
24	SHKOLLA SPORTIVE 4-VJEÇARE- PESHËNGRITJE
25	SHKOLLA SPORTIVE 4-VJEÇARE- VOLEJBOLL
26	SHKOLLA SPORTIVE 4-VJEÇARE- BASKETBOLL
27	PEDAGOGJIKE 4 VJEÇARE
28	PEDAGOGJIKE GREQISHT GJIROKASTËR
29	TEKNIKE 5 VJEÇARE EKONOMIST BANKE
30	TEKNIKE 5 VJEÇARE EKONOMIST TATIMESH
31	TEKNIKE 5 VJEÇARE EKONOMIST SIGURIMESH
32	TEKNIKE 5 VJEÇARE TURIZËM
33	TEKNIKE 5 VJEÇARE VETERINARI
34	TEKNIKE 5 VJEÇARE AGROBIZNES
35	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRIK I PËRGJITHSHËM
36	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRONIKË
37	TEKNIKE 5 VJEÇARE TELEKOMUNIKACION
38	TEKNIKE 5-VJEÇARE ADMINISTRIM DHE MIRËMBAJTJE SISTEMESH DHE RRJETESH KOMPJUTERIKE
39	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTROTEKNIKË
40	TEKNIKE 5 VJEÇARE MEKANIK I PËRGJITHSHËM
41	TEKNIKE 5 VJEÇARE PYJE
42	TEKNIKE 5-VJEÇARE TOPOGRAF
43	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK NDËRTIMI
44	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNOLOGJI USHQIMORE
45	TEKNIKE 5 VJEÇARE POLIGRAFIK
46	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK GJEODET
47	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 NDERTUES
48	HARRY FULTZ 5-VJEÇARE AUTOMEKANIK
49	HARRY FULTZ 5-VJEÇARE BIZNES
50	HARRY FULTZ 5-VJEÇARE ELEKTRIKE
51	HARRY FULTZ 5-VJEÇARE ELEKTRONIKË
52	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 FERMER
53	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 HOTELERI TURIZËM
54	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 MAKINERI BUJQËSORE
55	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 AUTOMEKANIK
56	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE BYLMET MISH
57	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE PIJE KONSERVA
58	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 INSTALUES PAJISJESH HIDROSANITARE DHE VENTILUESE
59	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 HIDRAULIK
60	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 KONFEKSION-STILIM
61	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 PËRPUNIM DRURI
62	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 PËRPUNUES DRURI
63	PETER MAHRINGER 3+2 -VJEÇAR TEKNOLOGJI INFORMACIONI
64	TEKNIKE 4 VJEÇARE (PARA 2007)
65	TEKNIKE PROFESIONALE ME KOHË TË SHKURTUAR
66	PROFILI IM S'ËSHTË NË LISTË